

LIGJ
Nr.7724, datë 21.6.1993

PËR RREGULLIMIN E KOHËS SË PUNËS DHË TË PUSHIMIT

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Ky ligj rregullon kohën e punës e të pushimit për punëmarrësit në sektorin shtetëror dhe privat.

Neni 2

Subjekti

Dispozitat e këtij ligji janë të detyrueshme për të gjitha kategoritë e punëmarrësve dhe të punëdhënësve.

Neni 3

Në bazë të këtij ligji Këshilli i Ministrave nxjerr akte të veçanta për punëmarrësit dhe punëdhënësit:

1. Në bujqësi e blegtori dhe ata të subjekteve që grumbullojnë e përpunojnë produkte bujqësore e blegtorale ose që janë të lidhura me to.
2. Në transportin hekurudhor, ujor, ajror, urban të udhëtarëve dhe të mallrave.
3. Në shërbimin e furnizimit të popullsisë me bukë, furrat e bukës dhe në shërbimin e hoteleve e të restoranteve.

Neni 4

Përkufizime

1. Me termin "kohë normale e punës" që më poshtë quhet "kohë pune" kuptohet koha efektive e punës nga fillimi deri në mbarim, pa përfshirë pushimet e ndryshme brenda saj.

2. Me termin "kohë pune mbi kohën normale të punës", që më poshtë quhet "mbikohë", kuptohet koha në të cilën punëmarrësi punon para dhe pas kohës së punës, në ditët e zakonshme ose në ditët e pushimeve e të festave zyrtare.

Nuk quhet mbikohë koha e punës, gjatë së cilës nëpunësi i administratës dhe i institucioneve shtetërore, qendrore e lokale punon mbi kohën normale të punës për plotësimin e detyrës në funksionin organik të tij.

3. Me termin "kohë pushimi", që më poshtë quhet "pushim" kuptohet ndërprerja e përkohëshme e punës. Gjatë pushimit nuk mbaron marrëdhënia juridike e punës, në të njëjtin vend pune.

4. Me termin "punë me ndërresa" kuptohet puna, që për shkak të procesit teknologjik ose natyrës së saj, gjatë 24 orëve nuk mund të ndërpritet.

5. Me termin "pagë" kuptohet paga bazë dhe shtesat mbi të që kanë karakter të përhershëm.

KREU II KOHA E PUNËS

Neni 5

1. Koha e punës është jo më shumë se:
 - a) 8 orë në ditë dhe
 - b) 6 orë në ditë për punëmarrësit që nuk kanë mbushur moshën 18 vjeç. Kësaj kategorie punëmarrësish i paguhet shtesë page për 2 orë në ditë.
2. Koha javore e punës është jo më pak se 40 orë. Ajo caktohet me kontratë kolektive e individuale, ndërsa për institucionet buxhetore caktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 6

Për punëmarrësit që punojnë në punë të vështira ose të dëmshme për shëndetin, caktohet një kohë pune më e shkurtër se sa ajo e parashikuar në nenin 5 të këtij ligji, pa ulje page, që rregullohet me kontratë kolektive e individuale, ndërsa për institucionet buxhetore caktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Këshilli i Ministrave përcakton vendet e punës të vështira dhe të dëmshme për shëndetin e punëmarrësve.

Neni 7

Koha e punës në ndërresat e dyta e të treta paguhet më shumë se koha e punës në ndërresën e parë.

Për punëmarrësit që punojnë në ndërresat e dyta e të treta me kontratë kolektive e individuale, caktohet shtesë page që është përkatësisht jo më shumë se 20 për qind dhe 50 për qind e pagës për kohën e punës të ndërresës së parë. Për punëmarrësit në institucionet buxhetore shtesa e pagës për këto ndërresa caktohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Quhet kohë pune nate puna e kryer nga punëmarrësi prej orës 23⁰⁰ deri në orën 6⁰⁰. Punëmarrësi, i cili punon pa ndërprerje gjatë këtyre orëve, paguhet për një orë shtesë. Në rastet kur punëmarrësi punon më pak se 7 orë, atij i paguhet shtesë page në raport me orët e punës që punon gjatë natës. Paga për orën shtesë llogaritet një orë page e ndërresës së parë.

Punëmarrësit e mitur, që nuk kanë mbushur moshën 18 vjeç, gratë dhe ata që kanë raport mjekësor, invaliditeti sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore", ndalohen të punojnë në ndërresën e tretë në orët e natës.

Këshilli i Ministrave përcakton sektorët ku lejohet puna e grave në ndërresën e tretë.

Neni 8

Fillimi dhe mbarimi i kohës së punës përcaktohet me kontrata kolektive e individuale dhe për institucionet buxhetore me vendim të Këshillit të Ministrave.

Për disa ditë të javës mund të caktohet një kohë pune më e gjatë, kurse për ditët e tjera më e shkurtër, por me kusht që të mos kalohet koha e punës javore e ditore sipas përcaktimit të nenit 5.

KREU III MBIKOHA E PUNËS

Neni 9

Mbikoha është jo më shumë se 2 orë në ditë dhe 240 orë në vit. Mbikoha rregullohet me kontrata kolektive e individuale. Për institucionet buxhetore mbikoha rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Për punëmarrësit që nuk kanë mbushur moshën 18 vjeç, mbikoha është jo më shumë se 2 orë

në ditë dhe 120 orë në vit.

Neni 10

Mbikoha mund të zgjatet tej kufive të përcaktuar në nenin 9 të këtij ligji, kur kryhen punime të rëndësishme për nevoja urgjente në dobi të popullsisë, në rastet e forcave madhore, si dhe në raste të tjera të përcaktuara me kontrata kolektive e individuale. Për institucionet buxhetore mbikoha për këto raste mund të zgjatet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 11

Për punëmarrësit, të cilët punojnë në vende pune që përbëjnë rrezik për jetën ose shëndetin, koha e punës lejohet të zgjatet me kontratë kolektive e individuale, ndërsa për institucionet buxhetore me vendim të Këshillit të Ministrave.

Mbikoha e lejuar në këto raste është jo më shumë se gjysëm ore në ditë dhe 45 orë në vit.

Këshilli i Ministrave përcakton vendet e punës, që përbëjnë rrezik për jetën ose shëndetin e punëmarrësve.

Neni 12

Për punën e kryer në mbikohë punëmarrësit:

a) i jepet pushim ose

b) i paguhet shtesë prej jo më shumë se 25 për qind e pagës, për rastet e veçanta që përcaktohen me kontrata kolektive e individuale, ndërsa për punëmarrësit e institucioneve buxhetore, me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU IV KOHË E PUSHIMIT

Neni 13

Pushimi gjatë kohës së punës

Punëmarrësi ka të drejtë të bëjë pushim gjatë kohës së punës.

Kohëzgjatja e pushimit përcaktohet me kontrata kolektive e individuale dhe për punëmarrësit në institucionet buxhetore me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 14

Pushimi ditor

Punëmarrësi ka të drejtën e pushimit ditor, i cili nuk mund të jetë më i vogël se 11 orë në ditë, pa ndërprerje.

Neni 15

Pushimi javor

Punëmarrësi ka të drejtë për pushim javor të papagueshëm, 1 ditë në javë. Dita e pushimit javor të papagueshëm është dita e diel.

Pushimi javor është pa ndërprerje, jo më pak se 36 orë.

Neni 16

Për punën e kryer ditën e diel ose në ditët e festave zyrtare, punëmarrësit:

a) i jepet pushim në një ditë tjetër të javës, ose

b) i paguhet shtesë jo më pak se 25 për qind e pagës, për rastet e veçanta që përcaktohen me kontrata kolektive e individuale, ndërsa për punëmarrësit e institucioneve buxhetore, me vendim të

Këshillit të Ministrave.

Neni 17 **Pushimi vjetor**

Punëmarrësi ka të drejtë për pushim vjetor të pagueshëm jo më pak se 12 dhe jo më shumë se 21 ditë pune.

Kohëzgjatja e pushimit vjetor përcaktohet, në vartësi nga mosha, vjetërsia në punë dhe lloji i punës, me kontrata kolektive e individuale, ndërsa për institucionet buxhetore, me vendim të Këshillit të Ministrave.

Pushimi vjetor përdoret brenda vitit kalendarik dhe në raste të veçanta jo më vonë se deri në fund të tremujorit të parë të vitit pasardhës. Për efekt të lejes vjetore, në kohën e punës llogaritet edhe koha e paaftësisë së përkohshme në punë.

Për të miturit që nuk kanë mbushur moshën 18 vjeç, pushimi vjetor i pagueshëm është jo më pak se 15 ditë dhe jo më shumë se 24 ditë pune. Pushimi vjetor për efekt page llogaritet mbi pagën mesatare të vitit kalendarik të mëparshëm.

Neni 18 **Pushimi plotësues**

Punëmarrësi ka të drejtë të marrë pushim plotësues të pagueshëm. Kohëzgjatja e pushimit plotësues dhe kategoritë e punëmarrësve që e marrin atë, përcaktohen me kontratë kolektive e individuale, ndërsa për institucionet buxhetore, me vendim të Këshillit të Ministrave.

Kur punëmarrësit i takon të marrë dy ose më shumë pushime plotësuese, atëherë ai gëzon pushimin që është më i favorshëm.

Pushimi plotësues paguhet si pushimi vjetor.

Neni 19 **Pushimi i veçantë**

Punëmarrësi që merret me veprimtari shkencore ose krijuese, ka të drejtë për një pushim të veçantë vjetor të pagueshëm. Ky pushim nuk llogaritet në pushimin vjetor ose plotësues.

Kriteret për dhënien e pushimit të veçantë, kohëzgjatjen dhe masën e pagesës përcaktohen me kontratë kolektive e individuale, ndërsa për institucionet buxhetore, me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 20 **Pushimi i jashtëzakonshëm**

Punëmarrësit, kur martohet ose i ndodh vdekje në pjesëtarët e familjes së tij, i jepet 5 ditë pune pushim i jashtëzakonshëm, i pagueshëm.

Punëdhënësi, kur e gjykon të arsyeshme kërkesën e punëmarrësit, i jep atij pushim të jashtëzakonshëm të papagueshëm.

Kriteret dhe afatet për dhënien e këtij pushimi përcaktohen me kontratë kolektive e individuale, ndërsa për institucionet buxhetore me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 21

Punëdhënësi që nuk respekton dispozitat e këtij ligji për kohën e punës, mbikohën dhe pushimin, dënohet me gjobë nga 10000 deri në 50000 lekë nga zyrat e punës që e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin ku e ka qendrën e veprimtarinë punëdhënësi.

Neni 22

Punëdhënësi i dënuar me gjobë, sipas nenit 21 të këtij ligji, ka të drejtë të ankohet sipas

procedurës së parashikuar në ligjin nr.7697, datë 7.4.1993 "Për kundravajtjet administrative".

KREU V DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 23

Në kontratat kolektive dhe individuale të punës përcaktohen edhe:

- a) koha e punës;
- b) mbikoha;
- c) pushimi.

Neni 24

Punëdhënësit kanë të drejtë të zëvendësojnë përkohësisht në punë punëmarrësin, në rastet kur ai ndërpret punën për shkak se është me leje vjetore, plotësuese, shëdetësore ose kryen detyra të tjera të ngarkuara nga punëdhënësi. E drejta për të zëvendësuar punëmarrësin lind vetëm kur puna që ai kryen, nuk mund të ndërpritet.

Neni 25

Këshilli i Ministrave nxjerr aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 26

Kreu V, nenet 48, 50, 51 të Kodit të Punës, neni 23 i ligjit nr.7526, datë 3.12.1991 "Për marrëdhëniet e punës", si dhe çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 27

Ky ligj hyn në fuqi më 1.7.1993

Shpallur me dekretin nr.584, datë 29.6.1993 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.